



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.02.2021, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes, nënkryetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

**REND DITE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2020,
3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr.80/20, e datës: 29.06.2020,
4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P – 71510057-01687-3 në Zonën Kadastrale Rahovec,
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Rahovecit,
6. Shqyrtimi i Propozim vendimit për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilat shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të Komunës,
7. Informatë për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë”
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – A ka dikush të shtojë diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës: Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush ndonjë vërejtje apo të shtojë diçka rreth procesverbalit. Nëse jo atëherë e vë në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar e KPF-së, konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:
2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2020.

**Afrim Limani** – Përshëndetje për ju kryesues, anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Shuma e mjeteve të bartura nga viti 2019/2020 në vitin 2021 është në total prej 506,707,39 centë, që është një shumë goxha e konsiderueshme dhe realisht na zbutë situatën financiare që kemi si komunë. Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë 372,526, të hyrat vetanake të pranuar për këtë vit kemi

1,395,667 euro dhe kemi tejkalim të hyrave që me siguri kemi tejkalim të hyrave siç edhe jeni të informuar ne raportin financiar, pastaj i kemi edhe të hyrat nga muaji nëntor edhe dhjetor të cilët për shkak të mbylljes së vitit fiskal nuk kanë mundur me u shpenzua edhe janë bartë edhe krejt këto në total janë 1,768,194 euro, ku janë shpenzuar 1,261,486 euro dhe atëherë mbetja është 567,707 euro e ku i kemi ndaje këto mjete, ku pas një analize nga drejtoria për Buxhetë dhe Financa dhe duke u bazuar edhe ne rekomandimet e auditorit që na kanë dhënë, ne jemi orientuar kryesisht të mbulimi i obligimeve ndër vite që kemi pasur disa obligime financiare me vlera të vogla dhe i kemi mbyllë dhe pjesën tjetër të buxhetit e kemi orientuar kryesisht të kontratat e mëdha financiare që i kemi. Shuma për investime kapitale që kemi ndaje kryesisht është për investime kapitale dhe një pjesë prej 21,926 që vazhdimisht që po paraqiten dhe këto shkojnë në pozicionin e pagave në kuadër të Shëndetësisë që e kanë destinimin pagesa e kujdestarisë. Këtu kemi mjete të mjaftueshme financiare dhe kjo shumë sipas procedurave dhe rregullave duhet me bartë mirëpo mbledhjen e e ardhshme kur ta kemi me rishikim të buxhetit, atëherë si propozim do ta qesë se këto mjete duhet të shkojnë në mallra dhe shërbime eventualisht edhe ne investime kapitale në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë. Pra pjesa dërmuese e bartjes së mjeteve shkon në kuadër të investimeve kapitale me shumën prej 506,707 euro.

**Dervish Çadraku** - Te shpërndarja e mjeteve, janë disa numra që do ishte mirë të cilat ishte mirë me i ndaje disa mjete që mendoj se do të ishte e rëndësishme dhe domosdoshme dhe janë dy raste dhe në sivjet kemi bërë inaugurimin e objektit në Gradish, por siç e dimë aty nuk kemi parking kështu duhet mjete që me u krijue parkingu dhe ndoshta do të ishte mirë me u ndaje mjete prej këtyre mbetjeve edhe me bo një parking. Dhe e dyta do të ishte mirë që me ndaje mjete për projekt ose ku ka mbetur puna e ujërave të pjesa e rrugës Fortesë – Xërxe të pjesa që është e vërsuar me ujë dhe ky është një problem që është duke e përcjellë këtë sipërfaqe të tokave dhe tash duhet me bo një projekt që me vazhdua kjo punë që me u rregullua kjo pjesë e vërsuar me ujë që mos me pas problem këto toka që punojnë ata qytetarë dhe ju shkojnë dëm, pra do të ishte mirë me ndae mjete për këtë punë, që të ndërtohet ndonjë kanal kullues apo duhet të bëhet ndonjë projekt që të lëshohet rruga për me pas mundësi me punua bujqit dhe kjo ishte ajo vërejtja ime që me u ndae mjetet për këtë drejtim.

**Afrim Limani** – Faleminderit për pyetjen Dervish, veç janë të ndara mjetet për parking, pra shuma e mjeteve për parking dhe ajo është kuadër të projektit shtigjet e ecjes. Ndarja e mjeteve për një pjesë për kanal të kullimit dhe tokave bujqësore, kështu që në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë i kemi disa projekte të kanali i kullimit të tokave bujqësore dhe gjithashtu e kemi një projekt me të përgjithshëm që emërtohet kanali i kullimit të tokave bujqësore të komunave të Rahovecit, edhe në kuadër të këtij projekti në mundemi me i futë edhe këto paramasa dhe ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare në kuadër të këtij projekti edhe si propozim mundemi me dhanë edhe në kuvend edhe sigurisht që drejtori i ka në konsideratë kërkesën tuaj dhe e futë në paramasa në kuadër të atij projekti. Gjithashtu deshta të ju themë se me ligjin e financave publike dhe përgjegjësi e përcakton saktë që këto mjete mund të barten vetëm në obligime financiare në kuadër të projekteve ekzistuese ose projekteve që kanë qenë me herët. Por në mund me krijua edhe një projekt të ri dhe tash situata e krijimit të projektit të ri ka ndryshuar pasi në mbledhjen e shtatorit kam një informatë që ju nuk e keni pasi në mbledhjen e shtatorit të vitit 2020 kur keni aprovua buxhetin ka pasur edhe disa projekte të reja dhe tash realisht e them se një pjesë e atyre projekteve nuk kanë kaluar sepse sipas një udhëzimi të ri që e ka nxjerr Ministria e Financave, ai projekt nuk i ka pasur kriteret e mjaftueshme me kaluar. Ne i kemi 6 projekte të cilat nuk kanë kaluar dhe krijohet edhe tash nuk është momenti tash mirëpo krejt këtë mundemi me krye kur të bëhet rishikimi i buxhetit për ato projekte që nuk kanë kaluar dhe unë personalisht kam qenë atje dhe e kam diskutuar pasi ka probleme të ndryshme krejt komunat e Kosovës bile sa për informim komunës së Malishevës asnjë nuk i ka kaluar me vlerë mbi 2 milion euro dhe neve mbi 1 milion euro dhe krejt këto projekte në vlerë prej 160,000 të cilat nuk kanë kaluar mirëpo na kanë mundësuar që tash pas alokimit të buxhetit që po besoj që ka Marsi mundemi prapë me i futë ato projekte përmes sistemit Pip, mirëpo e rëndësishme është se duhet me kaluar përmes kuvendit dhe këto mjete barten në obligime financiare. Konsideroj se kemi bërë një analize jashtëzakonisht të mirë duke i marr parasysh edhe rekomandimet edhe auditorit që na ka dhënë që sa me pak me pas borje ndër vite dhe ne jemi nisur nga ky orientim edhe projektet që kanë vlerë me të madhe financiare. P.sh. Në Bujqësi ndërtimi i urës në fshatin

Çifllak nëse ju kujtohet ai projekt ka vlerë 5000 euro që ka pasur një urë e vogël me u ndërtuar edhe hiq me shume nuk është ajo vlerë, bile unë e mora pikërisht këtë shembull mirëpo përgjigja e tyre ishte se ju nuk keni dhënë shënime te mjaftueshme sepse sipas tyre urë me shume 5000 euro nuk ka askundë. Mirëpo kur ju shpjegova se do te ndërtohet një urë e vogël në një përroskë me një shume prej 5000 euro, kështu që kemi dhënë arsyeshmëri te mjaftueshme për te gjitha projektet mirëpo e mira kësaj është që na mundësohet edhe njëherë ne bujqësi, pastaj janë rrjetet antibreshër pastaj ne ekonomi janë dy projekte që nuk kanë kaluar si meremetimi i shtëpisë se verës edhe infrastruktura ne depot e matrexit, pastaj ne shëndetësi isha i befasuar pasi edhe vet kam punuar aty ne arsyeshmëri si meremetimi i sektorit të pediatriisë rregullimi i objektit që edhe ai nuk ka kaluar. Kështu që i nderuari Dervish kërkesën e juaj do ta kemi parasysh.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume drejtor për sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar për pikën e dytë, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë te rendit të ditës:

### **3. Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20, e datës: 29.06.2020.**

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Në bazë të nevojës që është shfaqur si kërkesë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike që e kemi propozua që të hedhet ne rend dite plotësim ndryshimi i rregullores për taksa tarifa për rregulloren që e kemi kaluar ne kuvend me datë 29.06.2020. Në këtë rregullore është e paraparë që një pjesë e këtyre taksave të bëhet për parkingje publike dhe ne kemi pasur kërkesa nga bashkësitë fetare për krijimin e parkingjeve publike dhe e kemi aprovuar mirëpo e kemi aprovuar me pagesë dhe pagesa është goxha e lartë mirëpo një udhëzues që e kemi në nivel Kosovës që është asocuar nga Asosacioni i Komunave te Kosovës ka propozuar që shumica e kuvendeve komunale, bashkësitë fetare te lirohen nga pagesa për parkingje publike nëse ka mundësi me u lirue. Unë këtu e hedhi ne propozim nga Komiteti për Politike dhe Financa nëse është mundësi që ne këtë ta shtojmë si draft si plotësim ndryshim të rregullores për taksa vetëm për bashkësitë fetare që përfshihen hoxhallarët, texhet etj, kështu që ne kemi një kërkesë që është pagesë shume e lartë që ka paguar për 3 muaj 320 euro për 4 parkingje që realisht është shume e lartë mirëpo ne shumicën e Komunave te Kosovës është p pagesë. Kështu që kërkoj nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa që të aprovohet kjo kërkesë.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, drejtorët që janë prezentë këtu, kolegët këshilltarë. Kur jemi te ky propozim për lirim e bashkësisë fetare siç thuhet këtu te automjeteve te tyre, po me intereson me ditë për këto parkingje publike dua të di që a kemi ndonjë parking publik që është me pagesë përpos oborrit pranë kuvendit komunal dhe nëse e aprovojmë këtë atëherë këto automjete këto automjete a do të kenë ndonjë shenjë se cili automjet lirohet pasi nuk është me rëndësi se cilës bashkësi fetare i takon apo mundet me qenë edhe ndonjë përfaqësues tjetër apo ndoshta i kanë ato shenjat e veta, kështu që po me intereson edhe kjo një sqarim me pas.

**Dervish Çadraku** – Ashtu si parafolësi e pata edhe unë pyetjen se si identifikohen këta njerëz ne momentin kur e shfrytëzojnë që a kanë kartela pasi nuk do te thotë me pas makinën por mundet me qenë personi që vjen zyrtarisht për një shërbim, kështu që kjo po me intereson.

**Përparim Krasniqi** – Në baze te kërkesës, parkingjet publike llogariten ato hapësira publike që ka hapësirë për me krijua parking publik dhe ne përmes drejtorisë për sinjalizim horizontal dhe vertikal që kemi kontratën e sinjalizojmë edhe e vendosim tabelën për bashkësinë fetare që e kemi si e kemi rastin konkret texhja Helveti të sheh Mehdi qe e kemi vendos shenjën vertikale dhe horizontale kështu që është vendos tabela që realisht krijohet parking për 4 vetura që i shërben vetëm për texhën, e cila është me pagesë pra vendoset tablat ekskluzive për institucionin që i përket me shenja vertikale dhe horizontale por gjithmonë duk u bazuar në pjesën ku ka hapësirë publike komunale, për shkak se e kemi me rregullore që krijohet parking publik ne qoftëse ka hapësirë publike komunale, siç e kemi rastin te sheshi Republika pastaj te texhja Sheh Mehdi qe ka pasur një hapësirë edhe kemi krijua 4 parkingje që i nevojiten për texhën ndërsa edhe dy parkingje i kemi lirue që janë te lira për publikun pa tabela që ju shërben qytetareve.

**Fehmi Cena** – Tash lind pyetja që kur te vinë në parkingun e komunës që nuk ka shenja, a janë te liruar apo nuk janë te liruar pasi sipas juve që thoni është vetëm aty ku del shenjëzimet e tyre siç e potencuat me rastin

konkret, kështu që është njësoj sikur parimi i automjeteve të rasteve të invalidëve apo personave me aftësi të kufizuara me shenjëzime kështu që edhe këto do të jenë në atë mënyrë.

**Përparim Krasniqi** – Shenjat ë janë të vizatuara dhe të identifikuar ato janë të lira kështu që ata i kanë kërkuar vetëm 4 parkingje për institucione edhe vendoset në vendim që e kemi edhe në rregullore ë lejohet pëlqimi për 4 parkingje mirëpo parkingu që i bashkëngjitet për të hendikepuaret e ë është paralel me parkingun që i ka kërkuar qytetari personi fizik apo juridik, kështu që ai është i lirë dhe mundet me parkue çdo qytetar pavarësisht që ka bo kërkesën sepse rregullorja çdo parking që e ka bo publik duhet me vendos edhe shenjë për hendikepun që është edhe patjetër me qenë sepse është rregullore. Kështu që ne po flasim për bashkësitë fetare duke u bazuar në udhëzuesin që është në nivele komunal në nivele gjithë Kosovën dhe shumica e komunave në rregulloren për taksa dhe tarifa këto bashkësi fetare janë të lira nëse kërkojnë dhe gjithmonë duke u bazuar gjithmonë nëse ka hapësirë për krijimin e parkingjeve e rastin konkret po e marrim te qendra e qytetit nëse bashkësia fetare si xhamitë kërkojnë që me pas një parking për 3 apo 4 vetura atëherë ne si komunë në bazë kërkesës së tyre e bëjmë pëlqimin edhe i vizatojmë në mënyrë horizontale dhe vertikale shenjëzimin dhe i japim mundësi me shfrytëzua atë parking që ska të drejtë përveç institucionit që i përket. Ndërsa sa i përket komunës, komuna e ka me vendim dhe shfrytëzues është shoqata e veteranëve.

**Kryesuesi** - Faleminderit shumë për sqarimet, atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, atëherë konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01687-3 në zonën kadastrale në Rahovec.**

**Afrim Oruqi** – Të nderuar drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni vendimin e kryetarit të Komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës Nr. 01687-3 në zonën kadastrale në Rahovec, që është afër objektit të Harejës që është e prezentuar me ortofoto. Është një rrugë e hapur me shumë se 50 vite por jo rrugë nuk është me kadastrë pasi secili pronar ka lëshuar para parcelës së vet dhe shfrytëzohet në atë pjesë mirëpo një pronar ka kërkuar prej neve këmbim ose shpronësim sepse deshiron me ndertuar një objekt aty dhe ligjerisht edhe pjesa e parcelës që ne po e shpallim zone me interes të përgjithshëm është e tij dhe ka të drejtë me ndertuar objekt dhe po kërkoj prej juve që të shpallim zone me interes të përgjithshëm sipërfaqen prej 81 metra katror prej sipërfaqes së përgjithshme prej 3 ari e 19 metra katror e cila është e evidentuar në emër të NTP-Agronomi. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm është pastaj që kur ta marrim fillimisht prej juve aprovimin për interes të përgjithshëm pastaj në një seancë tjetër të kërkojmë pëlqimin për këmbim dhe që të evidentohet si rrugë publike. Ftojë anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor për sqarimet, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

#### **5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Rahovecit.**

**Artan Asllani** – Përshëndetje për të gjithë. Për këtë rend dite keni propozuar si drejtori të dalim me dy propozime dhe njëra nga ato është edhe lirim nga taksa komunale për vitin 2021 për të gjitha ato biznese të cilat janë të ngarkuara sipas rregullores në fuqi, duke parë vështirësitë që janë shfaqur edhe gjatë vitit 2020 edhe këtë vit që po vazhdojnë, kemi pretenduar që sado pak të ju dalim në ndihmë të gjitha bizneseve të komunës së Rahovecit me disa propozime dhe njeri nga këta është edhe lirim nga taksa komunale.

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju kryesues, drejtorët, anëtarët e KPF-së dhe gjithë të pranishmit tjerë. E kam një pyetje për drejtorin sa biznese llogariten të lirohen prej kësaj takse, kështu që kërkoj informatë nga drejtori.

**Fehmi Cena** – Mendoj se është në rregull edhe unë e pëlqej këtë fakt që në shenjë të ndihmesës së bizneseve të Komunës tonë për shkak të situatës së vështirë që ka shkaktuar pandemia, po dëshirojmë me i ndihmuar bizneset duke i liru nga taksat edhe gjithashtu mendoj që për mbledhjen e ardhshme nëse nuk i keni tash këto shifra që i tha parafolësi, mendoj që për mbledhjen e ardhshme të kuvendit komunal do të ishte mirë me i pas ato shifra edhe për numrin e bizneseve edhe për shumën e përgjithshme që do të kushtoj komunës nga

lirimi i këtyre pagesave sepse ajo është një pjesë e buxhetit që do të hyje në arkën e komunës për të cilën në kemi diskutuar edhe ju keni planifikuar për vitin 2020 që ta kemi një pasqyre me të qartë si Kuvendare.

**Artan Asllani** – Atëherë pothuajse të dy parafoletë e kanë parashtruar të njëjtën pyetje. Prej të gjitha bizneseve që janë në komunën e Rahovecit sipas rregullores së vitit të kaluar që ka hyrë në fuqi të datës 29.06. 2020, komuna e Rahovecit i ka 75% të bizneseve të liruara nga taksat komunale, ku 25% prej tyre janë bankat siç edhe e kemi çekur në material, kompanitë e telekomit, KED-si, barnatoret shëndetësore, pompat e derivateve dhe kompani të sigurimit gjithashtu ka edhe biznese tjera, ku 528 biznese janë aktualisht që kanë ngarkesë në taksa afariste komunale në vlerë prej 98,000 euro ngarkesë vjetore. Mirëpo te propozimi e keni të shënuar që mos ta çekim përsëri të pika 2, kështu që mos me lanë arkën pa të hyra pasi komuna e Rahovecit nuk ka edhe të hyra të mjaftueshme, jemi përkujdesur që gjatë pandemisë po supozoj bankat kompanitë financiare kemi pasur një qarkullim siç janë kompanitë telekomit, KED-sit, barnatoret të gjitha këto nuk i kemi hequr dhe nuk kemi vendos në këtë propozim, përjashtimisht janë gastronomia e sidomos hoteleria që nuk është e liruara nga taksa po ashtu janë edhe disa biznese tjera që direkt e prekin qytetarin e ndoshta edhe ndonjë kompani që nuk është e fortë. Pra janë 528 biznese që kanë ngarkesë aktualisht me ngarkesë vjetore afërsisht 98,000 euro dhe nëse i lirojmë të gjitha këto atëherë me shumë dalin mbi 70% që po dojmë me i lirue ndërsa 30% janë që nuk lirohen të ky propozim mirëpo që të hyrat ndoshta i kanë me shumë se 60,000 euro në lirim të këtij propozimi. Pra këto 7 biznese nëse nuk i lirojmë d.m.th. janë pjesa dërmuese e të hyrave mirëpo esenca është të ju dalim në ndihmë këtyre personave fizik mirëpo që janë direkt pronar individual me kompani të vogla pra biznese të vogla. Te pika e 3-të sigurisht që janë obligative që gjatë vitit 2020 të gjitha ato biznese që nuk i kanë krye obligimet të i paguajnë obligimet e mbetura për me pas mundësi me qenë përfitues për vitin 2021.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë drejtor për të gjitha sqarimet, a ka dikush edhe diçka sa i përket pikës së pestë të rendit të ditës, atëherë konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

#### **6. Shqyrtimi i Propozim vendimit për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilët shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të komunës.**

**Artan Asllani** – Po ashtu edhe në këtë pikë kemi kërkuar që të bëhet lirim i 50% i ngarkesës vjetore për të gjitha bizneset e komunës së Rahovecit të cilët e shfrytëzojnë objektet komunale. Bëhet fjalë për 30 lokale afariste dhe një aneks. Po ashtu në këtë propozim kemi vendos një pikë që obligon të gjithë shfrytëzuesit që gjatë vitit 2020 që borgjet obligimet që me pas mundësi me qenë përfitues i 50% të qirasë gjatë vitit 2021 dhe me se largu të i paguajnë obligimet e mbetura deri me 31 dhjetor të këtij viti.

**Rasim Fazliu** – Edhe për këtë pikë e përshëndes drejtorin që ka marr këtë propozim që me i lirua nga qiraja disa biznese me 50%. Edhe këtu për mbledhje të kuvendit do të ishte mirë me tregue që folëm edhe në pikën paraprake sa biznese lirohen edhe shumat që lirohen afërsisht, që me ditë që për sa po shkarkohet buxheti sepse ndikon drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që i kemi paraparë kur e kemi miratua buxhetin.

**Artan Asllani** – Në vazhdimisht i kemi të gjitha shënimet si në takse e po ashtu edhe në qiraje, pronaret obligimet dhe ngarkesat që janë për komplet vitet atëherë mbetet që me ja bashkëngjit edhe në formë tabelore sa është ngarkesa për të gjitha bizneset. Të gjitha këto shënime i kam dërguar në zyrën ligjore mirëpo realisht te propozimet apo vendimet qoftë në KPF apo në Kuvend nuk po ju bashkëngjisim, kështu që për mbledhje të kuvendit do ta keni materialin.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor për sqarimet, atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i përket pikës së gjashtë të rendit të ditës, kalon për kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

#### **7. Informatë për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit të Bardh të Ura e Fshejtë”.**

**Rumir Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, kolegë drejtorë. Po e paraqes një informatë mbi gjendjen e zonës së mbrojtur Kanioni i Drinit të Bardh të Ura e Fshejtë. Kjo zonë është e ndarë në tri kategori apo në tri zona. Informatën e kam paraqitë mbi gjendjen e objekteve që janë të ndërtuara aty për shkak se si drejtor i Urbanizmit mundem në këtë pikë me u përgjigj. Në zonën e parë janë të ndërtuara restoranti i cili ka kontratë me komunën e Rahovecit që funksionon prej vitit 2013 që e ka kontratën e fundit pastaj shtëpizat malore që janë në shërbim të restorantit me po të njëjtin pronar që po ashtu ka kontratë me

komunën e Rahovecit në vitin 2016 e ka të nënshkruar kontratën përmes ankandit publik. Ndërsa në zonën e dytë gjendet kompleksi memorial apo obelisku që janë 5 objekte banimi që janë kryesisht në zonën kadastrale të fshatit Gexhë dhe tri garazha që janë në shërbim të shtëpive të banimit. Ndërsa në zonën e tretë është betonjerka që ka pëlqim prej kuvendit komunal të Rahovecit pastaj janë dy restorante që nuk funksionojnë dhe gjithashtu aty afër është një restorant që funksionon të penda ku pronari ka pëlqimin prej departamentit të ujërave nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pastaj një objekt banimi dhe afarizëm që është restorant "Mergimi", një objekt banimi që është në zonën kadastrale në Xerxë dhe tre objekte industriale që me gjasë janë të ish ndërmarrjes publike 1 Maji. Disa prej objekteve kanë pëlqime prej komunës së Rahovecit siç e kam çekur edhe në informatë por pjesa tjetër e shtëpive e sidomos të ndërtimeve private nuk kanë leje dhe janë të ndërtuara kryesisht para luftës ose menjëherë pas luftës. Kjo ishte informata sa i përket kanionit të Drinit të Bardh.

**Rasim Fazliu** – Në mbledhjet e kaluara kam kërkuar që të na jepet informatë rreth kanionit të Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë që me dit se kush janë ata pronarë që I kanë ato toka që me I identifikue sepse faktikisht ka edhe presione sepse shume objekte janë ndertuar në menyre të egër dhe pa leje dhe tash përmes ngushtimit të kësaj zone të Kanioni I Drinit të Bardhë po deshirojmë me bo legalizimin e objekteve që I kanë ndertuar dikur me heret, pasi une kështu e kam kuptuar jo tash por para me shume se 5-6 vite kete problem pasi ka qenë I parashtruar edhe me heret si problem por sidoqoftë ne jemi shtet dhe duhet me bo një zgjidhje edhe për ata njerzë se a i kanë ndertuar me leje apo leje edhe duhet me ju dhanë njerëz pergjigje edhe atyre. Por këtu e kam e kam ditur se janë dy zona, zona e ngushtë dhe e gjërë sipas informative që kemi pasur mirpo siç po shihet tani në informatën e fundit kjo precizohet në 3 zona, kështu që objektet që janë në zonën e ngushtë pasi ketu thotë se jam shume objekte dmth informata me numra është gjithqka në rregull mirpo ndoshta kur të vjen momenti me u trajtue ajo zone siç e kemi pasur kërkesën për rendin e ditës, megjithatë kjo si informatë nuk është edhe aq e plotë, prap ka diqka që është e pakuptueshme ku thuhet për 9 objekte mirpo në nuk e dime se cilat janë ato. Kështu që unë tani për tani e marrim kështu siç është si informatë mirpo kur të vjen me u shqyrtue në kuvend si pike e rendit të ditës, unë dua të di me emer dhe mbiemer për secilen parcelë dhe object edhe sigurisht se kur e ka marr atë tokë, kur është bërë pronar I asaj tokes dmth me pas informata sa me të thukta dhe të detajizuara në menyre që me dit në fakt se qka po kërkohej dhe cilat janë veprimet që deshirojmë të I marrim. Mirpo tash për tash mëqenese nuk e kemi për shqyrtim kete pike ete rendit të ditës por si informatë është e përgjithshme por jo e mjaftueshme. Kështu që e falenderoj drejtorin kështu sin a ka sjellë mirpo për të ardhmen do ti kërkojmë në menyre të detajuar dhe jo në menyre të përgjithshme.

**Kryesuesi** – Ateher mëqë nuk kemi tjetër të lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

#### 8. Të ndryshme.

Ateher mëqë nuk kemi askënd të lajmëruar sa i përket kësaj pike, të nderuar kolegë, drejtorë dhe gjithë juve të pranishëm, ju falenderoj për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,  
  
Agim Hoti

